



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	10-02
Nr. i Faqeve Dr. Stranica No. Pages	-03-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	1918-2/25
Dati: Datum: Date:	02.06.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	02.06.2025
REFERENC-Ë:	25/1918/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	NTP "Ballkan - 1" Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 25/1918/151/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim procedimi administrativ** i kërkesës së Kompanisë NTP "Ballkan - 1" Ferizaj për Shtallën e lopëve, therrtore dhe depon e lëkurave, në Fshatin e Vjetër, Ferizaj.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundim procedimi administrativ i kërkesës së NTP "Ballkan - 1" Ferizaj, për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për Shtallën e lopëve, therrtore dhe depon e lëkurave, në Fshatin e Vjetër, Ferizaj.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës së NTP "Ballkan - 1" Ferizaj për fabrikë për Shtallën e lopëve, therrtore dhe depon e lëkurave, në Fshatin e Vjetër, Ferizaj është konstatuar se:

- Pëlqimi i Komunës nuk specifikon lejimin e ushtrimit të veprimtarisë për të cilën ka aplikuar, në ngastrën kadastrale P-72217087-00346-0, në Fshatin e Vjetër, Ferizaj

Njoftimi për informata shtesë - plotësim dokumentacioni, aplikuesit i është dërguar me datë 21.03.2025.

Dokumenti i kërkuar është sjellur brenda afatit të përcaktuar ligjor, me datën 22.05.2025, por njoftimi nga Komuna nuk përmban informatën e cila i është kërkuar, por japë informata për procedurat për shfuqizim të PZHK, e cila informatë nuk është relevante për Komisioni e VNM-së.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI lëshon Vendimin për **Përfundim procedimi administrativ** të kërkesë për për pajisje me Pëlqim Mjedisor.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/1918/1- ZSP/ /25 datë: 02.06.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit
3. Komisionit për VNM
4. Inspektoratit
5. Komunës së Ferizajit
6. Kabinetit të Ministrisë
7. Divizioni për komunikim me publikun
8. Arkivit të MMPHI

z. Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

